

Sazet e Bylbyl Vlorës

Familjen Ceno-Vlora disa e konsiderojnë të ardhur nga Gjirokastra, të tjerë i quajnë sot me të drejtë vlonjatë, ndërkohë që origjina e vërtetë e familjes së tyre është nga Përmeti. Bilbili e mësoi gërnetën nga i jati-Abdyli[1]. Më 1922 fillon aktivizimin si saze kryesisht të përbëra nga elementë të familjes. Pas një dasme në Kaninë, sazet e tij filluan të pëlqeheshin, duke u futur natyrshëm në jetën e qytetit. Më 1925, dalin jashtë Vlorës për të bërë muzikë në Berat. Po më 1925, sazet e Bilbilit ftohen në qytetin e Shkodrës nga familja Marubi me ndërmjetesinë e Shtjefën Gjeçovit dhe Dom Mark Vasës, i cili punonte në këtë kohë në kishën katolike të Vlorës. Në vitin 1927 dhanë koncerte në Leçe të Italisë. Në vitet '40, vendi me i pëlqyer i tyre, por në përgjithësi i muziktarëve popullorë të Vlorës, kanë qënë pijetoret e Osmanllinjve dhe të Moneve. Holli i shtepisë së Eqrem bej Vlorës ka qënë gjithashtu një nga vendet e pëlqyera ku bënin muzikë sazet e Bilbilit.

Problematika që të ofrojnë Sazet e Bilbil Vlorës, është e lidhur me të gjithë atë trashëgimi që Vlora dhe qytete të tjera të Labërisë u përballën për të formuar kulturën muzikore qytetare. Deri në fund të viteve '20, në qytetin e Vlorës, sipas opinionit më të përhapur, këngët qytetare "...këndoheshin vetëm në disa grupe familjesh vlonjate që bënin miqësi me fshatrat përreth"[2]. Në rast se muzika polifonike toske (me kontribute që vinin nga sazet e qyteteve të ndryshme), u shndërrua në një stereotip të ri duke u shoqëruar me saze, për polifoninë labe kompleksiteti i saj paraqiste deri diku vështirësi që lidheshin me "cënimin" dhe interpretimin e saj në rrugë të tjera. Kështu i gjithë problemi përmbledhej në faktin që, ashtu si në polifoninë fshatare, edhe në muzikën me saze të respektohej formula e "marrësit", "prerësit", "kthyesit" dhe "isos". Ky ishte realisht një problem, të cilin (në atë moment të dhënë), nuk mund ta ballafaqoje edhe me përvojën që vinte nga muzika popullore tradicionale me vegla e po kësaj zone (si dhe e asaj përreth), pasi ajo përfaqësohej në forma më rudimentare të të shprehurit polifonik dhe me një "ngushtim"(numur të paktë) të qendrave urbane të Labërisë ku do të zhvillohej muzika me saze.

Ashtu si dhe në rastin e muzikës me saze të qyteteve toske, edhe sazet e Bilbil Vlorës u orientuan për nga folklori tradicional i fshatit. Për këtë arsye, Bilbil Vlora dhe shoku i tij i sazeve Riza Bylbyli do të mbeten reformuesit kryesorë të këngëve qytetare vlonjate me saze, të mbështetura mbi ato polifonike popullore me iso, si dhe autori i strukturimit të "Kabasë labçe-labërishte" me gërnetë. Kjo është e dukshme në të, pasi kënga qytetare e Vlorës "...është e përngjashme me këngët fshatare pa saze të fshatrave përreth si: Kaninë, Drashovicë, Oshëtimë, Panaja, Cerkovinë" [3], të cilat u bënë thelbi i këngës së re qytetare vlonjate. Kuptohet që praktika e sazeve e zgjidhi këtë çështje në vijueshmëri dhe në përputhje me traditën pararendëse. Kështu, këngët "labçe" me saze krijuan realitetin tjetër të madh, që

muzika me saze formësoi në këtë kohë. Me realizimin e tyre, u orientua krijimi i repertorit muzikor dhe veçanërisht kënga popullore qytetare labe. Regjistrimet diskografike të Bilbilit janë bërë kryesisht pranë “COLUMBIA”-s.[4](foto 28-b)

Ndër këngëtarët dhe interpretët e shquar të këngës qytetare labe të kësaj kohe, përmendet edhe Zoj Havaja”[5] etj. Tradita e krijuar në këto vite në këngën dhe, më gjerë, në muzikën popullore qytetare të Vlorës, e vazhdoi pas viteve ’50 formacioni i njohur me emrin “Trioja vlonjate”[6].

[1] I jati i Bilbilit, Abdyl Ceno, lindi në Përmet, më 1868. Mëson që fëmijë gërnetën. Rreth 1890-1895 ai e zotëronte atë në një mënyrë virtuoze, gjë për të cilën ra dhe ne sy të disa tregtarëve nga Janina, të cilët bënë tregëti lëkurësh dhe sendesh të tjera me qytetin e Përmetit. Ata e morën atë së bashku me shokët e tij (si Fadilin me llautë etj.) për të bërë muzikë në Janinë, me pagesë. Më 1897, sazeve u bashkëngjiten edhe dy sazexhinj nga Delvina (një violinist dhe tjetri llautar), me të cilët Abdyl punoi për rreth gjashtë muaj në Stamboll. Më 1905 lëviz me familjen në Gjirokastër, ku qëndron për rreth dhjetë vjet. Rreth 1914-1916 familja shpërngulet përfundimisht në qytetin e Vlorës.

[2] Shiko dhe Haxhi Dalipi “Meditime për këngën qytetare vlonjate”, tek “Reshat Osmani dhe kënga qytetare e Vlorës”, fq. 43, Tiranë, 1996.

[3] “Reshat Osmani dhe kënga qytetare e Vlorës”, fq.42.

[4] Shiko Katalogun e regjistrimeve diskografike.

[5] Ka regjistruar tek “Columbia” këngët “Përmbi Tepelenë ma kishe shtëpinë” dhe “Të më donte nëna mua”. (pllakat me nr 65337, 65276). Për më se 20 vjet këndoi në Stamboll, ku edhe vdiq në fund të viteve ’40.

[6] “Trioja Vlonjate” përbëhej nga Reshat Osmani (1927-1994), Kostandin Thana (1929) dhe Meliha Doda (1933). Për më gjerë shiko dhe Bardhosh Gaçe “Reshat Osmani dhe kënga qytetare e Vlorës”. Tiranë 1996.